




Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2017




Pasuria bruto nga fillimi detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 17.2 herë.

+ 2,434,969 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash



Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2003-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	23,206,780	28.3%
Të ardhura nga aktiviteti si notere e bashkëshortes	56,047,805	68.4%
Paga e familjarëve	1,149,639	1.4%
Të ardhura nga qeraja	720,000	0.9%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	800,000	1.0%
Total	81,924,224	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me probleme
13 Pa Probleme

Subjekti Enrik Haxhiraj rezultoi me burime të pamjaftueshme financiare në vitin 2004 për të justifikuar shtesën e pasurisë në shumën 1,430,489 lekë (duke mos llogaritur shpenzimet e konsumit jetik, të cilat do e thellonin dhe më tepër këtë diferencë).

Ndër vite, subjekti dhe bashkëshortja e tij deklarojnë kredi dhe huamarrje në shumë të konsiderueshme si burimin kryesor të investimit në pasuri të paluajtshme. Kreditë bankare ndër vite janë vlerësuar në total 23,389,214 lekë, ndërsa huamarrja në shumën 11,263,800 lekë. Një kategori tjetër detyrimesh është dhe detyrimi ndaj shoqërisë sipërmarrëse, e cila në total ka qenë 9,308,310 lekë dhe pavarësisht shlyerjeve periodike ndër vite, ky detyrim në fund të vitit 2017 është rreth 4,077,000 lekë.

Në vitin 2010, subjekti ka deklaruar dy pagesa me qëllim blerje trualli në favor të ALUIZNI Vlorë, të kryera për legalizimin e shtëpisë në lagjen Uji i Ftohtë, 1.78 mln lekë bono privatizimi dhe 1,623,400 lekë. Në lidhje me bonot e privatizimit, nuk ka të dhëna që subjekti t'i ketë pasur në zotërim si dhe nuk jepet çmimi i blerjes.

Në vitin 2013, është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit "njësi shërbimi sip 23.8 m2 e ndodhur në Vlorë në bazë të kontratës së shitjes" me palë blerëse subjekti fizik në vlerën 9.000.000 lekë - nuk është e qartë nëse pagesa është bërë nga burimet familjare apo nga kapitali i personit fizik.

Në vitin 2015, subjekti deklaroi dhurim nga prindërit të një njësie me sipërfaqe 20.8 m2 në Vlorë.